



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
S-038
Prishtinë, më 30 korrik 2015

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 30 DHE 31 KORRIK 2015**

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Ai procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Margarita Kadriu-Ukeli, Labinotë Demi-Murtezi, Ali Sadriu, Rexhep Selimi, Donika Kadaj-Bujupi, Shukrije Bytyqi, Blerta Deliu-Kodra, Fatmir Rexhepi, Teuta Haxhiu, Zafir Berisha, Aida Dërguti, Salih Salihu, Pal Lekaj, ministri Avdullah Hoti, Daut Haradinaj, ministri Arsim Bajrami dhe ministri Valon Murati, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Daut Haradinaj, parashtroi pyetje për ministrin, Skender Hysni, në lidhje me hartimin e Projektligjit për Pensionimin e parakohshëm të Policisë së Kosovës. Ministri Skender Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Rustem Berisha parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me hapjen e një programi të ri studimor për fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në Universitetin e Prishtinës. Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Rustem Berisha.

Deputeti Rustem Berisha parashtroi pyetje për ministrin Lutfi Zharku në lidhje me përgatitjet e shtetit të Kosovës për marrjen e përgjegjësisë të plota për kontrollin e hapësirës ajrore mbi territorin e Kosovës nga viti 2019.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetit Rustem Berisha.

Deputetja Teuta Haxhiu parashtroi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me planet për formimin e një aviokompanie shtetërore të Republikës së Kosovës lidhur me transportin e ajror.

Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Deputetja Teuta Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me faktin se 200 nxënës shqiptar të Gjimnazit “Ruzhdi Berisha”, të cilët ka dy vite që i vijojnë mësimet në Komunën e Prizrenit, edhe pse në Komunën e Dragashit ekziston objekti i tyre.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Deputeti Slavko Simiq parashtroi pyetje për ministrin Skënder Hyseni në lidhje me siç tha ai rritjen e numrit të incidenteve ndaj komunitetit serb, me fokus në Fshatin Gorazhdevc, në Klinë dhe në Komunën e Graçanicës. Cilat masat janë duke u ndërmarrë nga strukturat e sigurisë për arrestimin e personave përgjegjës për veprat e kryera?

Ministri Skënder Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me prioritetin për hapjen e një kopshti publik në qytetin e Prizrenit.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Luljeta Veselaj-Gutaj.

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për ministrin Blerand Stavileci në lidhje me rindërtimin e Termocentralit “Kosova A”.

Ministri Blerand Stavileci nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për ministrin Blerand Stavileci në lidhje me mbulimin e dallimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga “Kosova e Re” dhe çmimet e blerjes nga KEDS si dhe kush do ta mbulojë atë dallim në çmim.

Ministri Blerand Stavileci nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Salih Salihu parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me atë se çfarë është ndërmarrë nga ministria që ai drejton për zgjidhjen e problemit të shtratit të Lumit Morava, i cili shkakton dëme të konsiderueshme fermerëve dhe ekonomive familjare të Komunës së Vitisë.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Salih Salihu.

Deputeti Ismajl Kurteshi parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me rastin e spitalit privat “International Hospital Medicine” nga Turqia në Kosovë me arsyetim se kishin trajtuar dy pacientë që kishin vdekur muaj më parë. Çka do të ndërmerrni ndaj mjekëve të QKUK-së, Klinikës së Kardiologjisë, Inspektoratit Shëndetësor dhe Bordit Etik si dhe a do ta inicioni mbylljen e Spitalit Turk?

Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me planifikimin e marrjes së masave për ndërprerjen e praktikave të këqija të cilat po ndodhin me rastin e ekskursionit të maturantëve në fillim të vitit shkollor.
Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputetja Xhevahire Izmaku parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me mundësinë që shteti i Kosovës të pajiset me vaksinën për parandalimin e kancerit në mitër.
Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ilir Deda parashtroi pyetje për zv/kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se kush e ka nënshkruar aplikacionin për anëtarësimin e Kosovës në UNESCO.
Zv/kryeministri Hashim Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Ilir Deda.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve që dalin nga raporti i Komisionit FunkSIONAL Parlamentar për zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.
Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Mytaher Haskuka parashtroi pyetje për ministrin Avdullah Hoti në lidhje me veprimet e ndërmarra nga Qeveria për zbatimin e dispozitës të nenit 14 të Ligjit për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës.
Ministri Avdullah Hoti iu përgjigj pyetjes së deputetit Mytaher Haskuka.

Deputetja Aida Dërguti parashtroi pyetje për ministrin Lutfi Zharku në lidhje me kriteret e vlerësimit në realizimin e projekteve infrastrukturore, me fokus në aksin rrugor Prishtinë-Mitrovicë, në afërsi të fshatrave Stanovc dhe Lumëmadh.
Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetes Aida Dërguti.

Në vazhdim, për plotësimin e rendit të ditës u paraqitën deputetët: Daut Haradinaj, Muhamet Mustafa, Nait Hasani dhe Xhevahire Izmaku.

Daut Haradinaj, në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, propozoi që në rendin e ditës të seancës së sotme të shqyrtohet pika - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin.

Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, propozoi që në rendin e ditës të seancës së sotme të shqyrtohen pikat, si në vijim: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-026 për markat tregtare dhe Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për patentat.

Nait Hasani, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, propozoi që në rendin e ditës të seancës së sotme të shqyrtohen pikat, si në vijim:

Emërimi i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kinematografinë.

Xhevahire Izmaku, propozoi që pika - Zgjedhja e pesë (5) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, të radhitet si pikë me nr. 4 në rendin e ditës të seancës së sotme.

Në lidhje me propozimet për rendin e ditës diskutuan edhe deputetët: Albulena Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Salih Morina, Shpejtim Bulliqi, Bekim Haxhiu, Ali Sadriu, Nuredin Ibishi dhe ministri Arsim Bajrami, Teuta Sahatqija, Shqipe Pantina, Pal Lekaj, Kujtim Paqaku, Shukrije Bytyqi, Xhevahire Izmaku dhe Salih Morina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari i hodhi në votim një nga një propozimet e deputetëve: Daut Haradinaj, Muhamet Mustafa, Nait Hasani dhe Xhevahire Izmaku, lidhur me plotësimin e rendit të ditës.

Kuvendi, me shumicë votash, i miratoi propozimet e lartpërmendura të deputetëve: Daut Haradinaj, Muhamet Mustafa, Nait Hasani dhe Xhevahire Izmaku.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Interpelanca e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Memli Krasniqi,
5. Zgjedhja e pesë (5) anëtarëve të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kinematografinë,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për markat tregtare,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-029 për patentat,
11. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës.

* * *

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 16, 22 e 23 korrik 2015 dhe 23 korrik 2015.

4. Interpelanca e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Memli Krasniqi

Kryetari i njoftoi deputetët se deputetja Donika Kadaj-Bujupi, nga Grupi Parlamentar i AAK-së, e përkrahur nga 6 deputetë tjerë nënshkrues, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për të ftuar në interpelancë, z. Memli Krasniqi, ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në lidhje me situatën e rëndë në industrinë e prodhimit të qumështit dhe produkteve të tij.

Kryetari më tej tha se ministri Memli Krasniqi e ka njoftuar Kuvendin se pikat e adresuara në kërkesën e parashtruar për Interpelancë, veçanërisht te pjesa e rekomandimeve, nuk kanë të

bëjnë me fushën e përgjegjësive të ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, sepse ato lidhen me fushat e përgjegjësive të institucioneve tjera, përkatësisht të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës.

Kryetari ftoi propozuesin e interpelancës ta marrë fjalën.

Deputetja **Donika Kadaj-Bujupi** tha se për shkak të mungesë të ministrit Memli Krasniqi, e tërheq interpelancën nga seanca e sotme, sepse s’kemi me kë të diskutojmë dhe s’kemi me kë të debatojmë.

Ajo kërkoi që kjo interpelancë të radhitet pikë e rendit të ditës në seancën tjetër të radhës dhe ministri të jetë i pranishëm në sallë dhe t’u përgjigjet pyetjeve, të cilat i kemi ngritur nëpërmjet kërkesës për interpelancë.

Diskutimi i deputetes Donika Kadaj-Bujupi është dhënë i plotë në transkript.

5. Zgjedhja e pesë (5) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryetari i informoi deputetët se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës, dhe Kuvendit i ka paraqitur Rekomandimin për miratim.

Arsyetimin e Raportit me rekomandime në emër të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës e paraqiti deputetja Xghevahire Izmaku.

Më tej, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës, dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t’i propozojnë nga një anëtarë për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Bekim Haxhiu,
2. GP LDK - Salih Morina,
3. GP Vetëvendosje - nuk morën pjesë fare në votim,
4. GP AAK - Rustem Berisha,
5. GP LS - Adem Hoxha,
7. GP NISMA - Shukrije Bytyqi,
8. GP “6+” Kujtim Paqaku.

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Bekim Haxhiu.

Ai konstatoi se në votim morën pjesë 80 deputetë, ndërsa i pavlefshëm ishte 1 fletëvotim.

Rezultati i votimit është, si në vijim:

Për 4 pozita për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, 8 kandidatët e propozuar fituan votat, si në vijim:

Hasan Salihu i ka fituar 22 vota,
Hisen Berisha i ka fituar 22 vota,
Ismet Bexheti i ka fituar 22 vota,
Lirim Geci i ka fituar 22 vota,
Muharrem Shahini i ka fituar 22 vota,
Mimoza Hasani-Pllana i ka fituar 22 vota,
Mustaf Halili i ka fituar 22 vota dhe
Fehmi Ajvazi i ka fituar 22 vota.

Për 1 pozitë të anëtarit të Bordit nga radhët e komunitetit serb, 2 kandidatët e propozuar fituan votat, si në vijim:

Ivan Velković i ka fituar 39 vota.
Spasoje Cvetković i ka fituar 1 votë.

Në vazhdim, kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit shumicë shqiptar emërohen:

1. Hisen Berisha,
2. Mimoza Hasani-Pllana,
3. Ismet Bexheti dhe
4. Lirim Geci.

II. Mandati i të emëruarve në pikën **I** (një) të këtij vendimi zgjat tri (3) vjet.

III. Asnjëri nga kandidatët e përzgjedhur për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb: Ivan Velković dhe Spasoje Cvetković, nuk i fituan votat e nevojshme për t'u emëruar anëtar i Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

IV. Radiotelevizioni i Kosovës duhet të bëjë shpallje publike për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të RTK-së, nga radha e komunitetit serb, në pajtim me nenin 26.2 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kinematografinë

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për kinematografinë.

Ministri **Kujtim Shala** tha se ky projektligj trajton të gjitha aspektet e veprimtarisë kinematografike, respektivisht, organizimin, financimin, prodhimin, distribuimin dhe shfaqjen e veprave kinematografike, bashkëpunimit ndërkombëtar, inkurajimin dhe promovimin e krijimtarisë kinematografike, si dhe mbrojtjen e trashëgimisë kinematografike kosovare.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Kujtim Shala, është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport; Bekim Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Ismajl Kurteshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Rrustem Berisha, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Shukrije Bytyqi, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”; Duda Balje, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Raif Qela, Glauk Konjufca, ministri Kujtim Shala dhe Muhamet Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për Kinematografinë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-050 për kinematografinë.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e Projektligjit për kinematografinë dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional Raportues për Projektligjin për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore.

Raportin e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e paraqiti deputeti, Muhamet Mustafa.

Fjala e deputetit Muhamet Mustafa është dhënë e plotë në transkript.

Në lidhje me këtë projektligj diskutoi deputeti, Raif Qela.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31 dhe 32.

Amendamentet nr: 16, 17, 18, 19, 20, 21 u miratuan të plotësuara sipas propozimit të deputetit Muhamet Mustafa.

Në lidhje me amendamentin nr. 16 diskutuan deputetët: Shqipe Pantina dhe Muhamet Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në lidhje me amendamentin nr. 26 diskutuan deputetët: Teuta Sahatqija, Muhamet Mustafa, Ilir Deda dhe Blerim Grainca, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në lidhje me amendamentin nr. 27 diskutuan deputetët: Teuta Sahatqija dhe Muhamet Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 58,
Kundër ----- 8,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin Nr. 05/L-027 për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për Letërnjoftimin.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje e FSK-së, e paraqiti deputeti, Fadil Demaku.

Fjala e deputetit Fadil Demaku është dhënë e plotë në transkript.

Në lidhje me këtë projektligj diskutoi deputeti Shaip Muja.

Kryetari, i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Kuvendi nuk e miratoi amendamentin nr. 7.

Në lidhje me amendamentin nr. 7 dhe nr. 8 diskutuan deputetët: Nait Hasani, Teuta Sahatqija dhe Ilir Deda, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari më pas hodhi në votim amendamentin nr. 8.

Kryetari konstatoi se për shkak të mungesës së kuorumit nuk mund të procedohet me votimin e tekstit të projektligjit me amendamentet e miratuara.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për markat tregtare

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për markat tregtare.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e paraqiti deputeti Muhamet Mustafa.

Fjala e deputetit Muhamet Mustafa është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 52,

Kundër ----- 4,

Abstenime ----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për markat tregtare.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për patentat

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për patentat.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e paraqiti deputeti Muhamet Mustafa.

Fjala e deputetit Muhamet Mustafa është dhënë e plotë në transkript.

Në lidhje me këtë projektligj diskutoi deputeti Shaip Muja, Muhamet Mustafa dhe ministrja Hykmete Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari, për mungesë të kuoromit, nuk i hodhi në votim amendamentet e propozuara dhe e mbylli seancën e sotme në orën 17:50 minuta, për të vazhduar nesër në orën 10:00.

E premte, 31 korrik 2015

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 30 korrik

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i vazhdoi punimet e seancës plenare me pikat, si në vijim:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin

Kryetari hodhi në votim amendamentin me nr. 8.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 24,
Kundër ----- 35,
Abstenime ----- 4.

Në vazhdim, kryetari konstatoi se nuk miratohet amendamenti nr. 8, i propozuar nga deputeti Nait Hasani.

Në lidhje me amendamentin nr. 9 diskutuan deputetët: Xhavit Haliti, Qerim Bajrami, Fadil Demaku, Emilija Rexhepi, Fikrim Damka, Zenun Pajaziti, Myfera Shinik, Daut Haradinaj, Sabri Hamiti, Nuredin Ibishi, Melihate Tërmkolli, Kujtim Paçaku, Bojan Mitiq, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Duda Balje dhe Muhamet Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi Xhavit Haliti tha se nuk ka kuorum për procedimin me votim të kësaj pike të rendit të ditës.

Kryesuesi tha se kjo pikë mbetet për shqyrtim në Sesionin vjeshtor të Kuvendit.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për patentat

Kryesuesi tha se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e datës 30 korrik 2015, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim vazhdon në seancën e sotme.

Kryetari, i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 66,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-029 për patentat.

11. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës

Kryetari e njoftoi Kuvendin se Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport, e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Deputeti Salih Morina, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport, propozoi që kjo pikë të shtyhet për Sesionin vjeshtor për shkak të mungesës së ministrit.

Lidhur me këtë çështje diskutuan deputetët Ismajl Kurteshi dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari më pas e hodhi në votim propozimin e lartpërmendur të deputetit Salih Morina.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 3.

Kryetari konstatoi se kjo pikë shtyhet për Sesion vjeshtor të punimeve të Kuvendit.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

E përgatiti:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale